



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DELVINË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE/ NGRITJEN NË DETYRË NË SHERBIMIN CIVIL NË
KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, Bashkia Delvinë shpall procedurat e lëvizjes paralele , ngritjes në detyrë për pozicionin:

-1 (një) – Drejtoria e Shërbimeve Komunitare, Menaxhimit Bujqësor, Pyjet dhe Kullotat , Veterinarisë, Emergjencave civile, Ujitjes dhe Kullimit, Kategoria II-2

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm dhe për procedurën e ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë

**Afati për dorëzimin e dokumentave për
LËVIZJE PARALELE:**

22 Tetor 2025

**Afati për dorëzimin e dokumentave për
NGRITJE NË DETYRË :**

27 Tetor 2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

- a) Informon në mënyrë periodike eprorin direkt për problemet e ndryshme në lidhje me zbatimin e legjislacionit në fuqi.
- b) Ndjek detyrat e dhëna nga eprori direkt dhe raporton për to.
- c) Informon eprorin direkt në çdo rast të kërkuar për plotësimin e problemeve të dala në realizimin e tyre.
- d) Udhëzon stafin në përmbushjen e aktivitetit të përditshëm të drejtorisë dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin,
- e) Paraqet pranë eprorin direkt për miratim të gjitha projekt-vendimet për në Këshillin Bashkiak sipas problemeve që mbulon.
- f) Drejton dhe organizon punën e sektorëve që ka në vartësi sipas strukturës së miratuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.
- g) Kërkon llogari nga sektorët që të respektojnë afatet ligjore në realizimin e detyrave përkatëse.
- h) Kërkon nga vartësit zbatimin e disiplinës në punë dhe realizimin e detyrave funksionale të tyre.
- i) I propozon eprorit direkt ndërhyrjen pranë organeve kompetente për zgjidhjen e problemeve që dalin në sektorët që mbulon.
- j) Ndjek dhe Përfundon korrespondencën me Institucione te tjera për problemet që mbulon Drejtoria.
- k) Koordinon aktivitetin e punës midis Sektorët e të tij. Në përputhje me detyrat funksionale u cakton detyra specialistëve dhe ndjek dhe analizon zbatimin e tyre.
- l) Kryen vlerësimin e punës për vartësit e tij.
- m) Propozon masa administrative për punonjësit e vartësisë kur në mënyrë të përsëritur nuk zbatojnë detyrat e ngakuara dhe kryejnë veprime që janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
- n) Nëpërmjet analizave, seminareve, interpretimeve shkresore dhe verbale të akteve normative, ligjore dhe nënligjore, kontrollit direkt dhe nëpërmjet specialistëve, ndihmon në aftësimin profesional të sistemit të Bashkisë që merret me administrimin e fondeve buxhetore.
- o) Kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e shërbimeve, për shkeljet që bëhen nga subjektet e ndryshme shtetërore apo private në përdorimin e rrjetit përkatës, merr masa sipas kompetencave të caktuara me dispozitë.
- p) Planifikon prioritetet në fushën e investimeve.
- q) Verifikon ankesat dhe kërkesat e banoreve dhe parashikon zgjidhjen e problemeve të ngritura në to , lidhur me shërbimet publike.
- r) Kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore në fushën e shërbimeve publike, për shkelje që bëhen nga subjektet e ndryshme shtetërore apo private, merr masa sipas kompetencave të caktuara me dispozite.
- s) Përcakton nevojat për trajnim të stafit që ka nën varësi;

- t) Propozon masa administrative për punonjësit e vartësit kur në mënyrë të përsëritur nuk zbatojnë detyrat e ngarkuara dhe kryejnë veprime që janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon, kategoria II-2;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- ç) Të plotësojë kriteret e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e posaçme si më poshtë:

Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal “Master Shkencor” apo “Master Profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2(dy) vite akademike” në Shkenca Juridike/ Ekonomike/Natyrës/Inxhinjerike/Shoqërore. Diploma e nivelit Bachelor të jetë në të njëjtën fushë .

- Te kete minimumi 5 vit vjetërsi pune ne kete profesion .
- Të ketë njohuri mbi programet bazë të punës në kompjuter.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Bashkisë Delvine , dokumentat si më poshtë:

- a-Jetëshkrim i plotësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare.
- b-Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor).Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve.
- c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejtë në institucion, brenda datës **22.10.2025**

Bashkia Delvine

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **24.10.2025**, Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", faqen zyrtare të www.bashkaidelvine.gov.al në stenden e Bashkisë Delvine , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Lidhur me orën dhe vendin e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë, kandidatët do të njoftohen individualisht nëpërmjet adresës së e-mail nga Bashkia Delvine.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Bashkia Delvine , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin Nr 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendor "
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"i ndryshuar .
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike".
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
- Njohuri mbi Ligjin nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile"
- Ligji nr.57/2020 "Për pyjet"

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do te vleresohen për pervojen ,trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushen , si dhe çertifikimet pozitive .

Totali i pikeve per kete vleresim eshte 40 pike.

Kandidatet gjate intervistes se strukturuar me goje do te vleresohen ne lidhje me :

- a- Njohurite , aftesite , kompetencen ne lidhje me pershkrimin e pozicionit te punes ;
- b- Eksperiencon e tyre te meparshme ;
- c- Motivimin , aspiratat dhe pritshmerine e tyre per karrierren .

Totali i pikeve per kete vleresim eshte 60 pike.

Intervista e strukturuar me gojë synojnë vlerësimin e njohurive , aftësive dhe cilësive të lidhura me fushën sipas përcaktimit në pikën 1.4 të kësaj shpallje.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, lista e fituesve e përbërë nga kandidatë që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë do të shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë dhe standat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike nga Bashkia Delvinë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Lista e fituesve e përbërë nga kandidatët që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë do të shpallet në faqen e internetit www.bashkiadelvine.gov.al, ambientet e Bashkisë Delvinë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

2 NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët drejtuese.

Këtë Informacion do ta merrni në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit , dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Delvinë dhe standat e informimit të publikut duke filluar nga data **05.11.2025**.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse(vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë III-2, III-3
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e posaçme si më poshtë:

Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal “Master Shkencor” apo “Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2(dy) vite akademike” në Shkenca Juridike/ Ekonomike/Natyrës/Inxhinjerike/Shoqërore. Diploma e nivelit Bachelor të jete në të njëjten fushë .

- a) Te kete të paktën 5 vit vjetersi pune ne kete profesion .
- b) Të ketë njohuri mbi programet bazë të punës në kompjuter.
- c) Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar .

b-Fotokopje të diplomës dhe lister notash (përfshirë edhe diplomën bachelor, te noterizuara).Për diplomat jashtë Republikës së Shqipërisë të jetë njehsimi pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

e-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

f-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet në Bashkinë Delvine .

Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 27.10.2025 në adresën

**Bashkia Delvine
Lagjia “Sinan Ballaci “
Rruga “Nazif Haderi”**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Në datën **06.11.2025**, Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të www.bashkaidelvine.gov.al në stenden e Bashkisë Delvine , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Lidhur me orën dhe vendin e zhvillimit të testimit me shkrim, kandidatët do të njoftohen individualisht nëpërmjet adresës së e-mail nga Bashkia Delvine.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Bashkia Delvine , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri mbi Ligjin nr. 139 , datë 15.07.2017 “ Për vetëqeverisjen vendore “
- Njohurim mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”.

- Njohuri mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”
- Njohuri mbi Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Njohuri mbi Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”.
- Ligji nr.57/2020 “Për pyjet”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, totali deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konstiton në motivimin , aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën , totali deri në 40 pike;
- c- Jetëshkrimin , që konstiton në vlerësimin e arsimimit të parësor dhe të mesëm , të lidhura me fushën, deri në 20 pike.

Testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë synojnë vlerësimin e njohurive , aftësive dhe cilësive të lidhura me fushën si pasqyrim i përcaktimit në pikën 2.4 të kësaj shpallje.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, lista e fituesve e përbërë nga kandidatë që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë do të shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë dhe stendat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike nga Bashkia Delvinë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit “ si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Delvinë e stendën të informimit të publikut në Bashkinë Delvinë :

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit të dokumentacionit ,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e “Shërbimit Kombëtar të Punësimit “ dhe faqen zyrtare të Bashkisë Delvinë duke filluar nga data 05.11.2025.

